

# Si të ndizet zjarri lehtë

## Djegia e drurit me djegie nga lartë

**Djegia pa tym** – Metoda e re për ndezje të zjarrit është një mundësi e thjeshtë dhe e efektshme për të zvogëluar lirim të dendësive të dëmshme nga zjarri. Në këtë mënyrë druri digjet ngadalë nga lartë poshtë. Në krahasim me ndezjen e zjarrit nga poshtë kjo mënyrë e djegies së drurit rrjedh më ngadalë dhe është më lehtë të kontrollohet. Gazrat e krijuara vërshojnë nëpër flakën e nxehtë dhe digjen pothuajse krejtësisht.

**Zjarri ndizet nga lartë dhe vazhdon poshtë siç ndodh edhe me qiriun!**



### Për cilat djegie të drurit është kjo metodë e përshtatshme?



Për ndezjen e copave të drurit me lirim të gazrave nga lart



**Kamin dhe shporet për gatim**



**Kamin**



**Oxhak për akumulim të nxehtësisë**

Oxhak  
Lloj oxhaku

### Si të veprohet?



**Përgatitja:** Për një fillim me sa më pak lirim të gazrave nevojiten katër copa druri të thata pishe me një trashësi 3 x 3 cm dhe me një gjatësi prej 20 cm si dhe fitili për ndezje (p.sh kashta e drurit).



**Mënyra e ndezjes së zjarrit:** Kjo mënyrë e ashtuquajtura mënyrë me skelet për ndezje të zjarrit është thjeshtë e realizueshme si dhe zëvendëson letrën dhe kartonin. Të katër copat e drurit vendosini në mënyrë të kryqëzuar mbi njëra tjetrën si dhe fitilin për ndezje në mes tyre (shih rrethin e kuq).



**Vendosja e drurëve në Kamin:** Në hapësirën e madhe të furrës, si në kaminin e pasqyruar lart, vendosni copat e drurit në mënyrë të kryqëzuar, poshtë ato që janë më të trasha ndërsa lart më të hollat.



**Vendosja e mënyrës – skeletit për të ndezur drutë:** Mënyra e skeletit për të ndezur drutë ndërtohet mbi stivën e drurëve (copat e drurit të skeletit të vendosura në të kundërtën nga copat e vendosura lart për të filluar djegien. Mjafton një kashtë çibriti dhe flaka do fillojë.

## Si të vendosen drutë në furrat tjera?



Në furrat e ngushta shtrini copat e drurit horizontalisht përkatësisht me ballë përpara.



Në furrat e ngushta dhe të larta vendosni copat e drurit vertikalisht.



Në furrat e gjëra dhe me thellësi të vogël vendosni copat e drurit me pjesën e gjatë nga përpara.



Në oxhaqet e tjera copat e drurit vendosën me ballë përpara.

## Këshilla tjera për këtë proces

- Furrat ku digjen drutë të mos ngarkohen tepër dhe të merret parasysh edhe informacioni mbi përdorimin.
- Mos të ngulfatet zjarri duke e mbyllur furnizuesin me ajër ose derën e kaminit.
- Në rast të rimbushjes së furrës vendosni vetëm një dru. Këtë dru vendoseni direkt mbi prush në mënyrë që druri të fillojë të digjet menjëherë. Edhe pasi të rimbushni mos e ngulfatni zjarrin. Oxhaku nuk duhet të rimbushet.
- Kapakët e ajrit të mbyllën vetëm atëherë kur prushi të jetë pothuajse i shuar. Veprohet në këtë mënyrë që oxhaku të mos ftohet shumë shpejtë. Dera e oxhakit të mbyllet atëherë kur prushi të jetë shuar tërësisht.
- Prushi i ftohur të largohet me mbeturinat e tjera.
- Pastrimi i rregullt nga pastruesit e oxhaqeve ndikon në lirimin e ulët të pluhurit dhe materieve tjera.
- Informacione tjera mund të merrni edhe nga organet tjera kompetente (komuna, kantoni).

Informohuni edhe në këto faqe int.:

[www.holzenergie.ch](http://www.holzenergie.ch)

[www.fairfeuern.ch](http://www.fairfeuern.ch)

[www.umwelt-zen-](http://www.umwelt-zen-)

## Çfarë mund të digjet?



- Copa druri, të cilat janë tharë në një vend të mbrojtur mirë.
- Briket nga druri.
- Oxhaku / shporeti për ngrohje qendrore: Gjatësia e copave të drurit nuk duhet të jetë më e gjatë se max. 7-9 cm.
- Druri para se të digjet duhet të ruhet së paku një ditë në një dhomë të ngrohtë. Druri i ftohtë digjet me vështirësi.

**Metodat ndihmëse për të ndezur zjarrin mund të gjeni në pikat e shitjes së këtij profili dhe në supermar-**



## Çfarë s'mund të digjet?



Për të ndezur zjarrin më të përshtatshme janë fitilat sesa letrat, kartoni, druri nga arkat e përdorura, qeset, druri nga mobilet etj. Mbetjet e drurit nga ndërtimet e ndryshme nuk janë të përshtatshme për djegie.

Gazrat nga këto djegie dëmtojnë objektet si dhe shëndetin dhe ambientin tonë.

Është e ndaluar të digjen këto materiale.



**Pas 15 minutave djegie pa tym:** Tym do të thotë ndër tjera edhe pluhur i imët. Nëse çdo gjë shkon mirë nga fillimi i djegies së drurit atëherë pas 15 minutave djegia do të pasojë pa tym. Nëse një djegie druri zgjatë me tym më shumë se 15 minuta atëherë nuk janë duke u zbatuar rregulloret për mbajtjen e ajrit të pastër (LRV). **Në rast të tillë organi përgjegjës mund të caktojë standarde të tjera apo rregullore-masa tjera.**

## Ky fletëinformacion është mundësuar nga:

Zyra federale për energji BFE dhe Energji Zvicër. Zyra federale për ambient BAFU. Djegia e drurëve Zvicër SFIH. Shoqata e mjeshtrëve të pastrimit të oxhaqeve Verband Schweizer Hafner – Plattengeschaefte VHP. Zyrat përgjegjëse kantonale për mbajtjen e ajrit të pastër

### EnergieSchweiz

Holzenergie Schweiz · Neugasse 6 · 8005 Zürich

Tel. 044 250 88 11 · Fax 044 250 88 22 · [info@holzenergie.ch](mailto:info@holzenergie.ch) · [www.holzenergie.ch](http://www.holzenergie.ch) · [www.energie-schweiz.ch](http://www.energie-schweiz.ch)

Publikation-Nr. 315 - 2008/01